



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Vendimi nr.22/17

Data: 06.07.2017

Në mbështetje në nenin 32,34 dhe 54 të Ligjit nr. 03/L-229, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, te datë: 07 Tetor 2010, Gazeta Zyrtare nr. 88/25 Nëntor 2010; plotësim ndryshimi i tij Nr. 04/L-226, dhe neni 12, 13.1, 18 dhe 77 të Ligjit me Nr. 02/L-28 Për Procedurën Administrative, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ne mbledhjen e mbajtur me datën 6 Korrik 2017 mori këtë:

## V E N D I M

- I. Rasti me Nr.Prot. 50/17-02/H dt.01.03.2017, Kërkesë për AKK-në me qëllim të Rekomandimit të Mbrojtjes së Zonës së Rezervuar dhe Luftimin e Konkurrencës Jo-Ligjore nga Operatorët në Treg të Kosovës, nuk bie nën **Kompetencën e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.**
- II. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit të Komisionit.

## A R S Y E T I M

---

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, me datë 01.03.2017 ka pranuar kërkesën e Postës së Kosovës Sh.A. e regjistruar me Nr.Prot.50/17-02/H dt.01.03.2017, Kërkesë për AKK-në me Qëllim të Rekomandimit të Mbrojtjes së Zonës së Rezervuar dhe Luftimin e Konkurrencës Jo-Ligjore nga Operatorët në Treg të Kosovës.

### I. BAZA LIGJORE

Bazuar në nenin 32,34, të Ligjit nr. 03/L-229, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, datë: 07 Tetor 2010, Gazeta Zyrtare nr. 88/25 Nëntor 2010; plotësim ndryshimi i tij Nr. 04/L-226, dhe neni 12,13.1, 18 dhe 77 të Ligjit me Nr. 02/L-28 Për Procedurën Administrative .

## **II. PËR PARASHTRUESIN E KËRKESËS**

**Posta e Kosovës Sh.A.** - Është ndërmarrje publike e formuar me Vendimin e Qeverisë së Kosovës, si rezultat i ndarjes nga PTK Sh.A. dhe është funksionalizuar si kompani publike, nga data 01.08.2012. Posta e Kosovës Sh.A. është operator publik postar që operon në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve postare, bazuar në Ligjin 03/L-173 për Shërbimet Postare, si dhe Zona e Rezervuar që derivon nga neni 12 i të njëtit Ligj. Gjithashtu edhe autorizimet që ka nga MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik) dhe të njëjtat e obligojnë, që të ofrojë shërbime universale postare, e cila për këto shërbime është e licencuar nga Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare ( ARKEP ).

Posta e Kosovës është e licencuar edhe për ofrimin e shërbimeve financiare jo-bankare, shërbime këto që i ofron në bazë të licences që ka nga Banka Qendrore ( BQK ).

## **III. PËRMBAJTJA E KËRKESËS ( ANKESËS )**

Posta e Kosovës Sh.A. kërkon që faturat e zarfuar nga operatorët publik dhe privat të shpërndahen nga vet Posta e Kosovës Sh.A., përndryshe kjo formë e shpërndarjes nga vet operatorët është ndërhyrje në licencën e Postës së Kosovës, e cila ofron shërbime postare dhe komunikim me shkrim. Andaj, menaxhmenti i Postës së Kosovës Sh.A., kërkon nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, që ta trajtojë kërkesën e tyre dhe të ndalojë komunikimin me shkrim ndërmjet subjekteve private dhe publike me qytetarët në formën e pa zarfuar, pasi që këto veprime ndërhyjnë direkt në zonën e shërbimit postar, veprimtari e cila është e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-173 për Shërbimet Postare.

## **IV. SHQYRTIMI I LËNDËS**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ( më tutje ref. Autoriteti ) në ushtrimin e funksionit të tij zbaton dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, përveç rasteve kur me Ligjin 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës përcakton ndryshe .

Ndërkaq, Ligji 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në dispozitat e tij parashih dy forma apo raste, në të cilat Autoriteti nuk zhvillon procedura deri në Vendimin përfundimtar, por me Konkluzion i njofton palët, atëherë kur :

1. Shkeljet nuk kanë ndikim në treg
2. Konstaton se nuk ka argumente të mjaftueshme që të nxjerr Konkluzion për Fillimin e Procedurës, të njëjtin ia adreson paraqitësit të kërkesës ( ankesës ) .

## **V. DISPOZITAT LIGJORE**

“Nëse Autoriteti në bazë të iniciativës nga neni 34 i këtij ligji gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun relevant sipas nenit 34 nën-paragrafi 2.1 dhe 2.2 konstaton se nuk ka argumente për fillimin e procedurës në kuptim të dispozitave të këtij ligji, është i detyruar që pas konstatimit të gjendjes në tregun relevante më së voni në afat prej dhjetë (10) muajsh nga dita e pranimit të iniciativës për fillimin e procedurës, të marrë konkluzion dhe të njëjtin ia adreson paraqitësit të iniciativës sipas nenit 34 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.”

## **VI. KOMPETENCA LËNDORE ( Definicioni )**

Kompetenca lëndore për të vendosur në procedurën administrative caktohet sipas dispozitave me të cilat rregullohet fusha e caktuar administrative ose caktohet si kompetencë e organeve të caktuara.

Autoriteti ka shqyrtuar kërkesën, me Nr.Prot.50/17-02/H dt.01.03.2017, pas analizimit të lëndës nga të dhënat dhe dokumentacioni në dispozicion vlerësojmë se rasti, respektivisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës, nuk janë objekt i shqyrtimit nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, rrjedhimisht nuk bien nën dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, prandaj, Autoriteti nuk trajton lëndët dhe nuk zhvillon procedura për çështjet,që nuk i ka në **kompetencën** e vet.

## **VII. PIKËPAMJE E SHKURTËR MBI KONKURENCËN**

*Fusha e Zbatimit të Ligjit, Qëllimi dhe Raporti Ekonomik*

Ligji 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet, në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit të Kosovës, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Me këtë ligj përcaktohen rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimi i Autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës si dhe procedurat në zbatim të këtij ligji.

Në mënyrë që të jenë efektive, konkurrenca kërkon nga kompanitë-ndërmarrjet që të veprojnë të pavarura nga njëra-tjetra dhe të mos jenë subjekt i presionit nga konkurrentët .

Prandaj, për të informuar palën lidhur me kompetencën për shqyrtimin e rastit ka konsultuar edhe nenin 18 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative i cili në detaje informon palën për veprimet e mëtejme dhe **kompetencën lëndore** lidhur kërkesën, të cilën e kishte parashtruar pranë Autoritetit.

### **- Dorëzimi i gabuar i kërkesës te një organ që nuk ka kompetencë -**

*1. ” Në ato raste kur personat fizikë dhe juridikë, gabimisht, dorëzojnë kërkesat e tyre te një organ i administratës publike, që nuk ka kompetencë mbi çështjen që është objekt i kërkesës, për trajtimin e kërkesës do të ndiqet procedura e mëposhtme:*

*a) organi i administratës publike, të cilit gabimisht i drejtohet kërkesa, brenda 2 ditësh pune nga dorëzimi i kërkesës, merr vendim me anë të të cilit konstaton jo kompetencën nga ana e tij për çështjen;*

*b) në qoftë se organi kompetent të cilit duhet t’i kishte shkuar kërkesa i përket të njëjtës ministri, agjenci, institucion apo strukturë, kërkesa e dorëzuar gabimisht i dërgohet organit kompetent, e shoqëruar me një letër përcjellëse nga organi që e ka marrë gabimisht atë, të nesërmen e deklaramit të jo kompetencës. Personi fizik dhe juridik, që ka bërë dorëzimin e gabuar, njoftohet sipas procedurës së parashikuar në Ligjin . 02/L-28 për Procedurën Administrative ;*

c) në qoftë se organi kompetent të cilit duhet t'i kishte shkuar kërkesa, i përket një ministrie, agjencie, institucioni apo strukture tjetër, kërkesa e dorëzuar gabimisht i kthehet personit fizik dhe juridik që e ka dorëzuar 2 ditë pune pas ditës kur është bërë dorëzimi, e shoqëruar me një letër përcjellëse zyrtare, në të cilën përfshihet deklarimi i jo kompetencës, si dhe informacione në lidhje me organin kompetent të cilit duhet t'i drejtohet personi fizik dhe juridik.

2. Në rastin e parashikuar nga paragrafi 1, pika (c) e këtij neni, caktohet një afat i ri për përfundimin e procedimit administrativ. Afati i ri është i njëjtë me të parin dhe fillon të llogaritet që nga momenti kur është njoftuar personi fizik dhe juridik që ka dorëzuar kërkesën.

3. **Vendimi** i organit të administratës publike me anë të të cilit deklarohet jo kompetenca, mund të apelohej nga personat fizikë dhe juridikë sipas procedurave të parashikuara në nenin 28 të këtij Ligji ”.

**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, sipas Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, trajton këto forma të keqpërdorimeve të konkurrencës në treg :**

#### **Marrëveshjet e Ndaluar**

1. ”Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura ne mes te shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikrat e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që:

1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
2. kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
3. ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
4. zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese;
5. kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave ”.

#### **Abuzimi me Pozitën Dominuese**

”Abuzim i pozitës dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant është i ndaluar veçanërisht nëse:

1. në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthor vendos çmimin jo real të blerjes apo shitjes, ose kushte tjera të pa drejta tregtare;
2. kufizon prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknologjik në dëm të konsumatorëve;
3. zbatimin e kushteve të ndryshme të transaksioneve për punët e njëjta me ndërmarrjet tjera duke i sjellë ato në një pozitë të pafavorshme në raport me konkurrencën;
4. lidhja e kontratave, me kusht që subjektet kontraktuese të pranojnë detyrime shtesë;
5. vendosja e çmimeve ose e kushteve tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjen jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre;
6. refuzimi i hyrjes së një ndërmarrje tjetër, duke i dhënë një shpërblim të përshtatshëm në rrjetin ose në infrastrukturën e ndërmarrjes me pozitë dominuese, nëse ky refuzim i

*përdorimit të rrjetit ose të infrastrukturave pengon ndërmarrjen tjetër të veprave si konkurrent i ndërmarrjes me pozitë dominuese ”.*

***Përqendrimet e Ndaluar***

*”Janë të ndaluara përqendrimet e ndërmarrjeve që mund të dëmtojnë ndjeshëm konkurrencën, veçanërisht në qoftë se një përqendrim i tillë ka si pasojë forcimin e pozitës dominuese ekzistuese ose krijimin e një pozitë të re dominuese ”.*

**Kërkesa merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.**

**Këshilla juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa por pala me padi brenda 30 ditëve mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.*

Me këtë Vendim të njoftohen:

- *Pala*
- *Arkiva*

**KOMISIONI  
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

( \_\_\_\_\_ )

Valon Prestreshi  
Kryetar

( \_\_\_\_\_ )

Ahmet Krasniqi  
Zv. Kryetar

( \_\_\_\_\_ )

Fatime Haziri  
Anëtare

( \_\_\_\_\_ )

Muhamed Krasniqi  
Anëtar

( \_\_\_\_\_ )

Shaqir Morina  
Anëtar